



**Mirush Kabashi**  
**Mjeshtër i Madh i Skenës**

Mirush Kabashi ka lindur më 17/04/1948 në Shkodër, nga një nënë Durrsake, e baba Gjakovar. Është rritur në Durrës. Studimet e larta i ka kryer në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, ku është diplomuar si aktor në Degën Dramaturgjike më 1970. Nga janari i vitit 1971, filloi punë si aktor pranë trupës profesioniste të Teatrit "Aleksandër Moisiu" ku kontribuoi deri në fund të vitit 1993. Më 1994 u emërua në Radiotelevizionin Shqiptar, si ideator dhe prezantues i programeve artistike televizive. Kurse nga viti 2002, ai është inkadruar si aktor në trupën artistike të Teatrit Kombëtar, ku vazhdon të kontribuojë edhe sot. Nga viti 1985, ai është aktivizuar për disa vite me radhë edhe si profesor i Mjeshtërisë së Aktorit, pranë Akademisë së Arteve.

Veprimitaria e gjatë artistike përfshin: në teatër, rrith 100 role; në kinematografi, mbi 20 personazhe, më shumë se gjysma e të cilëve protagonistë; në televizion, dhjetëra programe, koncerte e filma televizivë; ndërsa, si recitues, ai është njëjtur në dhjetra skena në qytete e shtete të ndryshme të Evropës, të Amerikës më gjérë.

Mirush Kabashi është vlerësuar dy herë si "Aktori më i mirë", në Festivalin Kombëtar Teatrор 1990 dhe në Festivalin e Parë Mbarëkombëtar të Aktrimit 2002. Ai është nderuar gjithashtu me disa medalje për interpretim karakteresh në Festivalin Kombëtar të Filmit Shqiptar.

Kryeroli i tij në teatër është pa dyshim Sokrati. Në interpretimin e kësaj figure, Kabashi ka korrr vlerësimet më të larta të jurive dhe të kritikës në aktivitetet dhe festivalet ndërkombëtare ku ka marrë pjesë, si në Kairo, Kiev, Toronto, Prishtinë, Beograd, Vjenë, Plovdiv etj., duke i dhënë kësaj monodrame atributin e shfaqjes më prezantuese dhe më të vlerësuar të teatrit shqiptar në aktivitete ndërkombëtare.

Mirush Kabashi mban dy tituj të lartë të akorduar nga Presidenti i Republikës, "Artist i Merituar" (1983) "Mjeshtër i Madh i Skenës" (1998).



**Eric-Emmanuel Schmitt**

Ka lindur më 28 mars 1960 në Sainte-Foy-lès-Lyon. Në vitet 1980-1985, ka kryer studimet e larta në École normale supérieure në Paris, ku ka marrë dhe gradën "doktor në filozofji". Më pas, për tre vjet, ka dhënë mësim në Universitetin e Chambéry.

Karriera e tij si shkrimitar nisi në fillim të viteve '90 me pjesën teatrale "Don Zhuani ne gjyq". Më vonë, veprat e tjera dramaturgjike si "Variacione enigmatike", "I shthururi", "Milarepa" e "Frederiku ose bullevardi i krimit" do të dëshmonin se dramaturgia është arma më e fuqishme letrare e krijimtarisë së tij. Dhe këtë konstatim do ta afirmonte përfundimisht drama "Vizitor", e cila u vlerësua në vitin 1994 me tri çmime "Molier". Në vitin 2001, Eric-Emmanuel Schmitt u nderua me Çmimin e Madh të Teatrit, të akorduar nga Akademia Franceze.

Përveç dramave, ai ka shkruar dhe disa romane si "Sekti i egoistëve", "Ungjilli sipas Pilatit", "Oskari dhe zonja rozë" dhe "Jeta ime me Moxartin". I shkruar si një rrëfenjë shoqërore që dëshmon respektin e dobësinë e Schmitt-it për kulturën orientale, "Zoti Ibrahim dhe lulet e Kuranit" shpejt do të kthehet në sinonim dhe vetë emrin e këtij autorit të madh, mosha e re e të cilit përbën një garanci më shumë se letërsia franceze do t'i dhurojë botës letrare një tjetër vigan të pavdekshëm.



**Mirush KABASHI**  
**Mjeshtër i Madh i Skenës**

Monodramë  
sipas novelës:

**Zoti Ibrahim**  
**dhe lulet e Kuranit**  
nga Eric Emmanuel Schmitt

Me përkrahjen e Loterie Romande dhe Qytetit të Gjenevës



Avec le soutien de la  
VILLE DE GENÈVE

## DY FJALË PËR

"Zotin Ibrahim dhe ....

Kush janë Momo dhe zoti Ibrahim? Shumë është folur rreth faktit që djali është hebre dhe dyqanxhiu është mysliman. Dhe me të drejtë. Por unë e kam bërë me dashje një paraqitje të tillë. Vendosa të vërtetoj diçka, por edhe të provokoj.

Ajo çka doja të vërtetoja është fakti se në shumë vende të kësaj bote (kryeqytete të Evropës, qytetet porte, qytetet amerikane, etj.), njerëz me besime të ndryshme fetare dhe me kultura të ndryshme, bashkëjetojnë në harmoni me njëritjetrin.

Fatkeqësisht, lajmet që vijnë nga gazetat tregojnë se gjërat nuk janë aq në harmoni. Unë nuk dua të zvogëloj tragjedinë e konfliktit Izrael-Palestinë, por nuk duhet të ngatërrojmë zërin e tërësisë së jetës me klithmat e politikës apo të gazetarëve. Gjykova se ishte e rëndësishme të jepja një mesazh vëllazërimi dhe paqeje. U ndjeva krenar kur mësova se në Izrael, arabët, hebrenjtë dhe të krishterët e mbështetnin përdorimin e "Zotit Ibrahim dhe lulet e Kurabit" si mënyrë për përhapjen e shpresës.

Elementi provokues në vepër ishte paraqitja e fesë islamë në një dritë pozitive, në këto kohë kur kësaj feje i bashkëngjiten vetëm të këqija. Duhet ta dallojmë ndryshimin mes fesë islamë, një fe që frymëzon miliona njerëz, dhe disa militanteve.

Eric-Emmanuel Schmitt

## CITAT PËR TEATRIN

Filozofia pretendon ta shpjegojë botën, ndërsa teatri ta paraqesë atë. Duke i bashkuar këto të dyja, unë përpinqem të reflektoj duke e paraqitur dramatikisht gjendjen njerëzore, të shfaq intimitetin e pyetjeve të mia, pështjellimin dhe përvojën me humorin dhe lehtësinë që kanë paradokset e fatit tonë. Suksesi na bën të përvuajtur: ai që pata kujtar se është teatri im intim, doli se u përgjigjej pikëpyetjeve të shumë bashkëkohësve të mi dhe dëshirës së tyre të thelli për ta bërë jetën sérishmi magjike...

## VENDET KU ËSHTË LUAJTUR (ZOTI IBRAHIM DHE LULET E KURANIT)

Ndonëse si vepër letrare është një roman i shkurtër, "Zoti Ibrahim dhe lulet e Kurabit" është vënë në skenë në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme të botës. Madje në Francë është përshtatur edhe si film, ku rolin e Zotit Ibrahim e ka interpretuar aktori i madh hollivudian Omar Sharif, i cili është nderuar për këtë rol me "Çmimin e Paqes" nga OKB.

Që nga viti 1999, kjo pjesë është vënë në skenë në disa qindra teatro e në disa dhjetëra vende të botës si në Turqi, Gjermani (në dhjetëra teatro), Francë (në dhjetëra teatro), Belgjikë, Spanjë, Rusi, Izrael, Sh.B.A., Argjentinë, Poloni, Bullgari, Luksemburg, Zvicër, etj.

### Monodrama

Z. Ibrahim dhe lulet e Kurabit  
sipas novelës me të njëjtin titull nga  
Eric Emmanuel Schmidt  
shfaqet në:

**Théâtre Salle Centrale Madeleine  
Rue de Madeleine 10  
1204 Genève**

**Të shtunën, më 24 janar 2015  
në ora 20h00  
Hapja e dyerve në ora 19h00**

**Regjia dhe përshtaja skenike: Mirush Kabashi  
Fotografia elektronike: Tristan Sherifi  
Formulimi muzikor: Julian Shyti  
Mjeshtër ndriçimi: Luan Tapia**

**Le monologue  
Monsieur Ibrahim et les Fleurs du Coron  
d'après la nouvelle du même titre de  
Eric Emmanuel Schmid  
est représenté au**

**Théâtre Salle Centrale Madeleine  
Rue de Madeleine 10  
1204 Genève**

**Le samedi, 24 janvier 2015 à 20h00  
Ouverture des portes à 19h00**

**Metteur en scène et  
adaptation théâtrale: Mirush Kabashi  
Image électronique: Tristan Sherifi  
Sons/musique: Julian Shyti  
Lumières: Luan Tapia**

**Rezervimi: cageneve@gmail.com  
Info: www.cageneve.ch**